



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:011815

Datë: 18.12.2024

Numri i dokumentit: 06618208

C.nr.2254/2023

GJYKATA THEMELORE NË MIROVICË, si kontestimore, me Gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditëses F.T. nga Mitrovica, përfaqësuar nga Leutrim Ademi av me seli në Mitrovicë, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DSH, Objekti i Kontestit: Kompensimin i pagës së 13-të, jashtë seance me dt. 18.12.2024 nxjerr këtë;

A K T V E N D I M

Padia e paditëses F. T. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 29.12.2023, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DSH, Objekti i Kontestit: Kompensimin i pagës së 13-të, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësja F.T. nga Mitrovica, përmes të autorizuarit, ka ushtruar padi me dt. 29.12..2023, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DSH, Objekti i Kontestit: Kompensimin i pagës së 13-të.

Gjykata, me aktvendimin e dt. 13.07.2024, të pranuar nga i autorizuari i paditëses me dt: 30.10.2024, ka kërkuar nga paditësja që brenda afatit 3 ditor ta plotësoj- precizoj padinë, me paralajmërimin konform nenit 99 dhe 102 te LPK-së.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja nuk ka vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata për plotësimin- precizin e padisë, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 102.par 3 të LPK-së, padinë e paditëses F.T. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt.29.12.2023, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DSH, Objekti i Kontestit: Kompensimin i pagës së 13-të, e **KONSIDEROJ TË TËRHEQUR**.

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në vështrim të nenit 102.par 3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.2254/223 me dt.18.12.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 7 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.